

Statuti i Internews Kosova

Ky statut do të qeverisë organizatën jo-profitabile "Internews Kosova", të themeluar në pajtim me Ligjin për lirinë e asociimit në Organizatat Jo-qeveritare nr: Nr. 04/L-57

anizata joqeveritare

Neni 1- Emri, forma dhe adresa

- 1.1. Organizata duhet të quhet Internews Kosova
- 1.2. Organizata është shoqatë jo-profitabile, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare të Republikës së Kosovës.
- 1.3. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet jo-profitabile të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte për asnjérin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë, pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona kanë bërë për këtë organizatë.
- 1.4. Ndonjë transaksion në mes të anëtarëve, anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, personi ose nëpunësi dhe organizatës duhet të mbyllët në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.
- 1.5. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në: "Mensa e Studenteve" - Kati i parë, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Neni 2- Themeluesit

2.1. Themelues të organizatës janë:

Persephone Miel, 73 Rruga Spring nr.607, New York, NY 10012-5800
Gerd Greune, 81a Ave, Jan Stobbaerts, B-1030 Bruksel
Eric Johnson, 14 Cite Griset, 75011 Paris,
Ardian Kastrati, Kodra e Diellit, rr.3. Llam.10.nr.10. Prishtinë

2.2. Përfaqësues i autorizuar i organizatës është Faik Ispahi

2.3. Përfaqësuesi i autorizuar emërohet nga Kuvendi i Anëtarëve të organizatës dhe duhet të përfaqësojë organizatën në Kosovë dhe më gjerë, të pranojë të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës si dhe të ketë përgjegjësi për informimin e autoritetetëve relevante administrative për çfarëdo ndryshimesh në organizatë.

Neni 3- Qëllimi

3.1. Organizata është krijuar për këto qëllime:

- Të zhvillojë shoqërinë civile;
- Të kontribuojë në demokratizimin e shoqërisë;
- Të marrë pjesë, të mbështesë ose iniciojë projekte në fushën e debatit publik, llogaridhënie, sundimit të ligjit, zhvillimit ekonomik, arsimt, shëndetësisë, sociale, kulturës dhe të të drejtave të studentëve dhe rinisë së Kosovës në përgjithësi;
- Të promovojë demokratizim të procesit të mësimdhënieς në Universitetin e Prishtinës;
- Të rrisë kualitetin dhe profesionalizmin e studimeve shkencore profesionale.

Me kusht që t'i përm bushë qëllimet e veta, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet në aktivitetet në vazhdim.

- Të ofrojë trajnime profesionale dhe mundësi për praktikë studentëve, të rinjëve dhe përfaqësuesve të tjera të komuniteteve të nën përfaqësuara në të gjitha format mediale tradicionale, elektronike dhe online duke përfshirë gazetarinë, produksionin, menaxhimin, administrimin, etj..

- Të marrë pjesë, të mbështesë ose të iniciojë veprime, projekte dhe iniciativa të synuara për përmirësimin e jetës dhe aktiviteteve të studentëve të Universitetit dhe të rinisë së Kosovës në përgjithësi;
- Të promovojojë vlerat e shprehjes së lirë, dialogut konstruktiv dhe tolerancës;
- Të mbështesë projekte që synojnë të u japid studentëve të Universitetit dhe rinisë mundësi për shprehje në media të ndryshme duke përfshirë, por jo duke u limituar në ato audiovisuale dhe/ose të transmetimit, internet dhe media të tjera elektronike dhe në mbledhje publike;

Neni 4 - Anëtarësimi

- 4.1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike.
- 4.2. Kuvendi i anëtarëve do të vendosë nëse do të kërkohet pagimi i anëtarësimit nga anëtarët. Mos pagesa e anëtarësisë, pas paralajmërimit në të shkruar, do të shërbejë si bazë për përjashtimin e anëtarit nga organizata.
- 4.3. Anëtarësimi i ndonjë anëtarë gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve në rast të shkeljes së qëllimit të organizatës apo dispozitave të këtij statuti. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet.
- 4.4. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me shumicë të anëtarëve prezent.

Neni 5- Kuvendi i Anëtarëve

- 5.1 Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai duhet të përbëhet nga të gjithë anëtarët e organizatës.
- 5.2 Kuvendi i Anëtarëve duhet të ketë përgjegjësi për politikat dhe çështjet financiare të organizatës.
- 5.3 Përpos përgjegjësive të tjera të dhëna nga ky status, Kuvendi i Anëtarëve gjithashtu duhet t'i ketë këto kompetenca:
 - *Të zgjedhë Bordin e drejtoreve*
 - *Të aprovojë raporte nga zyrtarët;*

5.4 Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij ndonjë organi tjetër ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e shumicës së anëtarëve të tij.

Neni 6- Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve

- 6.1 Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) në të cilën do të rishikojë dhe aprovojë detyrimet, të hyrat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar. Po ashtu duhet të diskutojë Asetet e pritura, detyrimet, të hyrat dhe programet për vitin e ardhshëm.
- 6.2. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga gjysma e anëtarëve ose nga Bordi Drejtues. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Kryetarit i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat të shpjeguara në paragrafin 6.3.
- 6.3. Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ duke përshtirë datën dhe vedin e mbajtjes së mbledhjes, së basku me rendin e ditës për takimin do t'u shpërndahet gjithë anëtarëve së paku tre ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
- 6.4. Për mbajtjen e mbledhjes më së paku është e nevojshme pjesëmarraja e gjysmës së anëtarëve. Nëse ky minimum (kuorumi) nuk arrihet, takimi do të shtyhet për një ditë të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.
- 6.5. Secili anëtar i organizatës ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.



- 6.6. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent.
6.7. Secili anëtar i Kuvendit të Anëtarëve duhet të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 7 – Bordi Drejtues

- 7.1 Përveç fuqive të tjera të dhëna nga ky statut, Bordi i Drejtorëve do të ketë përgjegjësi për kontrollimin dhe menagjimin e punëve dhe pronave të organizatës. Bordi Drejtues gjithmonë duhet të veprojnë në përputhje me synimet e organizatës.
- 7.2 Përveç fuqive të tjera të dhëna nga këto statute, Bordi Drejtues do t'i kenë edhe fuqitë në vijim: Të përfaqësojë dhe të veprojë në emër të organizatës, të lidhin organizatën me ndonjë marrëveshje me nënshkrimin e dy drejtuesve; të nominojnë dhe të përzgjedhin zyrtarët; të vendosin fuqitë dhe detyrimet e secilit zyrtar.
- 7.3 Bordi Drejtues do të përbëhet nga anëtarë të organizatës. Ata do të përzgjidhen individualisht nga Asambleja e Anëtarëve me shumicë të thjeshtë.
- 7.4 Bordi Drejtues do të përbëhet nga së paku 3 (tre) Anëtarë: Kryesuesi, Sekretari dhe Arkëtari.
- 7.5 Anëtarët e Bordit Drejtues mund të përzgjidhen për mandate të njëpasnjëshme.
- 7.6 Anëtarët e Bordit Drejtues mund të largohen para mbarimit te mandatit të tyre me votim në MGV ose MGJ të Asamblesë së Anëtarëve.
- 7.7 Në rast vdekjeje, dorëheqjeje ose largimit të një anëtarit të Bordit Drejtues, Asambleja e Anëtarëve do të përzgjedhë një passardhës që të punojë përgjatë mandatit të mbetur.
- 7.8 Vendimet nga Bordi Drejtues duhet të merren me shumicë.
- 7.9 Bordi Drejtues mund të vendosë të parashtrojë çfarëdo çështje tek Asambleja e Anëtarëve për vendim.
- 7.10 Asnjë shpërblim apo kompensim nuk do të paguhet për Drejtuesit e Bordit pa aprovimin e Asamblesë së Anëtarëve dhe vetëm shpërblimet apo kompensimet e arsyeshme për punën e bërë për organizatën do të lejohen.
- 7.11 Çdo anëtar i Bordit Drejtues do të abstenojë nga të votuarit në vendimet ose në cilin do rast ku ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

Neni 8 – Drejtori Ekzekutiv

- 8.1 Drejtorin Ekzekutiv e emëron Kuvendi i Anëtarëve të Organizatës dhe ai është i autorizuari i organizatës. Ai/ajo zgjidhet me mandat 4 vjeçar me mundësi rizgjedhjeje.
- 8.2 Për punën e vet, drejtori i përgjigjet Kuvendit.
- 8.3 Koordinon punën ne mes të menaxherëve të projekteve dhe zyrtarëve të tjera.
- 8.4 Është përgjegjës, së bashku me menaxherët e projekteve, për përgatitjen e raporteve të punës.
- 8.5 Zhvillon raportet me organizatat tjera, me donatoret, me mediat dhe me publikun në përgjithësi.
- 8.6 Drejtori mund të barte disa nga kompetencat e tij tek zyrtarët tjera të organizatës.
- 8.7 Merr vendime financiare deri në vlerën 10,000 Euro.

Neni 9 - Zyrtarët dhe Punëtorët

- 9.1 Zyrtarët duhet të punësohen përmes konkursit publik ose rekrutimit të drejtpërdrejtë i cili detajizon të gjitha specifikat e punës.
- 9.2 Me Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës, si dhe me Rregulloren për Marrëdhënie Pune të Organizatës, përcaktohen më detajisht rregullat e brendshme për kryerjen e punëve dhe detyrat e punës për zyrtaret e organizatës

Neni 10 – Shpërbërja e organizatës

10. 1 Organizata mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit të Anëtarëve.

10.2 Kur të vemos për shpërbërjen e organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e organizatës. Shoqata(t) ose fondacion(i/et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjtë ose të ngjashme sikurse organizata.

Neni 11 – Ndryshimet e statutit

11. 1 Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me vendimin e dy të tretave të shumicës së Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 12 – Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

12.1 Bordi i Drejtorëve dhe Zyrtarët e caktuar duhet t'ia paraqesin raportet vjetore e Kuvendit të Anëtarëve të Organizatës, në MPV ose nëse kërkohet në MPJ.

12.2 Viti finanziar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.


Yllka Hoxha - Kryetare



Nënshkrimi dhe numri personal
1176179046



Faik Ispahi - anëtar



Nënshkrimi dhe numri personal
2004987317

Astrit Perani- anëtar




Nënshkrimi dhe numri personal
1000962658

Kreshnik Gashi- anëtar



Nënshkrimi dhe numri personal
1171848499

Basri Shala- anëtar



Nënshkrimi dhe numri personal
1015807730